



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.144

12 tetor

2009

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 144 datë 28.9.2009	Për disa ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar 6507
Ligj nr.10 145 datë 28.9.2009	Për një ndryshim në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar 6510
Ligj nr.10 146 datë 28.9.2009	Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar 6511
Ligj nr.10 147 datë 28.9.2009	Për një ndryshim në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar 6513
Ligj nr.10 148 datë 28.9.2009	Për një shtesë në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” 6516
Ligj nr.10 149 datë 28.9.2009	Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar 6517
Ligj nr.10 154 datë 28.9.2009	Për disa ndryshime në ligjin nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009” 6518

LIGJ
Nr.10 144, datë 28.9.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7928, DATË 27.4.1995
“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI :

Në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

1. Personi, që kërkon të regjistrohet, detyrohet të ndjekë rrugën e përcaktuar në ligjet nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, dhe nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Administrata tatimore, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” ka të drejtë të regjistrojë një person të tatueshëm edhe nëse ai nuk ka kërkuar të regjistrohet.”.

Neni 2

Në nenin 7, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Personi i tatueshëm, që kërkon të çregjistrohet, sipas përcaktimeve të bëra në paragrafin e parë, u nënshtrohet procedurave të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 3

Në nenin 26/1, në shkronjën “a” fjalja e fundit, me përmbajtje: “Kjo shkronjë nuk zbatohet për furnizimin në import të shtypshkrimeve dhe librave të çdo lloji”, hiqet.

Neni 4

Në nenin 40, në pikën 1 fjalët “në ligjin nr.7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”” zëvendësohen me fjalët “në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar”.

Neni 5

Neni 41 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 41

1. Administrata tatimore ka të drejtë të bëjë një vlerësim tatimor të shumës së TVSH-së kur:
 - a) personi nuk bën deklarin nga ajo periudhë kohe apo në formën, që përcaktohet në këtë ligj;
 - b) personi kërkon që shuma e TVSH-së, e paraqitur si e pagueshme në një deklaratë, të ndryshojë, për arsye të një gabimi a mangësie;
 - c) çmon se shuma e TVSH-së, e paraqitur si e pagueshme në një deklaratë të bërë nga një person i tatueshëm, është më e vogël se shuma që duhej të ishte pasqyruar si e pagueshme;
 - ç) personi ka qenë i çregjistruar, për shkaqet e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, me efekte nga data në të cilën ishte regjistruar;
 - d) personi duhej të arkëtonte një shumë TVSH-je për një faturë, në përputhje me pikën 6 të nenit 36 të këtij ligji;
 - dh) çmon se, për ndonjë arsye, shuma e TVSH-së, edhe pse është e pagueshme, nuk është paguar.
2. Administrata tatimore njofton me shkrim personin e tatueshëm për vlerësimin tatimor, duke i dërguar bashkëlidhur edhe kërkesën për të paguar detyrimin tatimor, TVSH-në e pagueshme, kamatëvonesat, si dhe gjobat, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në nenin 69 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.
3. Personi i tatueshëm detyrohet ta paguajë detyrimin tatimor, të vlerësuar sipas vlerësimit tatimor, të kryer në bazë të këtij neni, brenda 30 ditëve kalendarike, duke filluar nga data kur personi ka marrë apo vlerësohet ta ketë marrë njoftimin e vlerësimit dhe kërkesën për pagesë.”.

Neni 6

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 42

Ankimi administrativ tatimor

Çdo person, ndaj të cilit është bërë një vlerësim tatimor për TVSH-në, në përputhje me nenin 41 të këtij ligji dhe, për pasojë, organi tatimor ka nxjerrë njoftim për këtë vlerësim, nëse nuk është dakord, ka të drejtë të paraqesë ankim në Drejtorinë e Apelimit Tatimor, sipas afatit të parashikuar në pikën 3 të nenit 106 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ndjekë procedurat e apelimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.”.

Neni 7

Neni 43 “E drejta e ankimimit” shfuqizohet.

Neni 8

Në titull dhe në përmbajtjen e nenit 49, fjala “interesat” zëvendësohet me fjalën “kamatëvonesat”.

Neni 9

Neni 52 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 52

Rimbursimet, si pasojë e ankimit administrativ tatimor

Kur një vlerësim tatimor, në bazë të një ankimi administrativ tatimor, ulet apo anulohet, organet tatimore rimbursojnë personin, ndaj të cilit ishte bërë ky vlerësim tatimor, për të gjithë shumën e TVSH-së së paguar më tepër, sipas afateve dhe rregullave të përcaktuara në nenin 110 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 10

Në nenin 53 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Në titull fjala “Interesat” zëvendësohet me fjalën “Kamatëvonesat”.
- b) Shkronja “a” shfuqizohet.
- c) Fjalët “në njërën nga format e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” e “c” të pikës 3 të nenit 39 të ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, detyrohen të paguajnë interesat e përcaktuara në nenin 44 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” zëvendësohen me fjalët “në njërën nga format e përcaktuara në nenin 75 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, detyrohen të paguajnë kamatëvonesat e përcaktuara në nenin 76 të po këtij ligji”.

Neni 11

Në nenin 54, fjalët “neneve 45 e 46 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” zëvendësohen me fjalët “ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë””.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6279, datë 7.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 145, datë 28.9.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Lidhja nr.3, e përmendur në pikën 5 të nenit 4 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën nr.3 që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Për dekretet e nxjerra nga Presidenti i Republikës, për lënie të shtetësisë shqiptare, të pazbatuara deri në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk zbatohet taksa e pullës.

Neni 3
Shfuqizimet

Vendimi nr.550, datë 1.8.2003, i Këshillit të Ministrave “Për tarifat e shërbimeve, që kryhen nga shërbimi i gjendjes civile”, të ndryshuar dhe çdo dispozitë tjetër ligjore apo nënligjore, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6280, datë 7.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS

	Masa e taksës (në lekë)
1. Për lëshimin e certifikatave për përdorim brenda vendit	50 lekë
2. Për lëshimin e dokumentit "Certifikatë për lidhje martese" në gjuhë të huaj	200 lekë
3. Për lëshimin e dokumentit "Certifikatë lindjeje" në gjuhë të huaj	200 lekë
4. Për lëshimin e dokumentit "Certifikatë martese" në gjuhë të huaj	200 lekë
5. Për regjistrimin e shtetasve të huaj, pas dhënies së shtetësisë shqiptare	2 000 lekë
6. Për procedurën e ndryshimit të emrit/mbiemrit	1 000 lekë
7. Për mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës	1 000 lekë
8. Për procedurën për veçim/bashkim familjesh të shtetasve	1 000 lekë

LIGJ

Nr.10 146, datë 28.9.2009

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9632, DATË 30.10.2006 "PËR
SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në fund të nenit 24 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bëjnë regjistrimin apo çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e bashkisë apo komunës, i cili konfirmon pagesën e taksave respektive që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji."

Neni 2

Në nenin 27, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit."

Neni 3

Në nenin 32 pika 1, shkronja “b” shfuqizohet.

Neni 4

Pas nenit 32 shtohet neni 32/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 32/1

Taksa e tabelës

Kategoritë e bazës së taksës së tabelës dhe niveli i tyre jepen në ankesin nr.7, që i bashkëlidhet këtij ligji.”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6281, datë 7.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Aneksi 7. Taksa e tabelës

Kategoritë	Niveli i taksës
a) Tabelë për qëllime identifikimi	120 lekë/vit
b) Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike:	
i) Për Bashkinë e Tiranës	45 000 lekë/m ² /vit
ii) Për bashkitë qendër qarku	22 500 lekë/m ² /vit
iii) Për bashkitë e tjera dhe komunat	13 500 lekë/m ² /vit
c) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaiere, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.	1 000 lekë/m ² /ditë

LIGJ
Nr.10 147, datë 28.9.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8976, DATË 12.12.2002
“PËR AKCIZAT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Shtojca 1, që i bashkëlidhet ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën, me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6282, datë 7.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

Shtojca 1

MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kodi NK	PËRSHKRIMI	SHKALLA TATIMORE
I	KAFE	
09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	70 lekë/kg
09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	140 lekë/kg
09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	50 lekë/kg
21 01 11 21 01 12	Ekstrakte, esenca, koncentre kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.)	250 lekë/kg
II	LËNGJE FRUTASH, UJË DHE PIJE FRESKUESE	
20 09	Lëngje frutash dhe perimesh të pafermentuara, pa shtesa alkoolike, që përmbajnë ose jo lëndë ëmbëltuese	2 LEKË/LITRI
22 02	Ujërat minerale ose të gazuara, me ëmbëlsues ose aromatizues shtesë, pijet freskuese joalkoolike, përjashtim lëngjet e frutave	2 lekë/litri
III	BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE	
22 03	Birrë e bërë nga malto - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi $\leq 200\,000$ hektolitër/vit - Nga prodhues vendas e të huaj, me sasi $> 200\,000$ hektolitër/vit	30 lekë/litri 40 lekë/litri
22 04	Verë dhe verërat e gazuara, shampanjë, musht rrushi - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi $\leq 10\,000$ hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi $> 10\,000$ hektolitër/vit	20 lekë /litri 35 lekë /litri
22 05	Vermut e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi ≤ 300 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi > 300 hektolitër/vit	20 lekë /litri 35 lekë /litri
22 06	Të tjera pije të fermentuara (p.sh. cider, cider dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të papërmendura diku tjetër	20 lekë /litri
22 07 10 00	Alkool etilik jo i denatyrar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80 për qind ose më tepër	400 lekë/litri
22 07 20 00	Alkool etilik i denatyrar	0
22 08	Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit mbi 12 për qind - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi $\leq 20\,000$ hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj, me sasi $> 20\,000$ hektolitër/vit	220 lekë /litri 300 lekë /litri
	Pije alkoolike me forcë alkoolike ndaj volumit deri në 12 për qind	100 lekë /litri
22 08 20 29	Raki	100 lekë /litri

IV	DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ	
24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	2 500 lekë/kg
24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	50 lekë/paketa
24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	2 240 lekë/kg
24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prej duhani	1 500 lekë/kg
V	NËNPRODUKTET E NAFTËS	
27 10 11 41	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol)	37 lekë /litri
27 19 11 45	Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013gr/litër	
27 10 11 49	- Me më pak se 95 oktan	50 lekë /litri
	- Me 95-98 oktan	
	- Me 98 e më shumë oktan	50 lekë /litri
27 10 11 51	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër	
27 10 11 59	- Me më pak se 98 oktan	50 lekë /litri
	- Me 98 e më shumë oktan	
27 10 19 11 deri	Vajgurët	20 lekë/litri
27 10 19 29		
27 10 19 21	Karburantet, tip vajguri	0
27 10 19 31 deri		37 lekë/litri
27 10 19 49	Vajra të rënda (gazoil)	
27 10 19 51 deri		
27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	13 lekë /kg
27 10 19 71 deri	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/ kg
27 10 19 99		
27 13 11 00	Koks nafte dhe vajra të tjera	1 lek/kg
27 13 12 00		
27 13 20 00	Bitum nafte	5 lekë/kg
27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg
27 14 90 00	- Të tjera (bitum dhe asfalt natyror; asfaltet dhe gurët asfaltikë)	5 lekë/kg
27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpininën e katranit mineral (masticet bituminoze)	5 lekë/kg
29 01	Hidrokarbure aciklike dhe ciklike përfshirë (etilen, benzen, toluol, ksilol)	5 lekë/kg
29 02		
34 03 19 91	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg
34 03 99 10		
VI	ARTIKUJ KOZMETIKË, PARFUMERI DHE TUALETI	
33 03 00 10	Parfume	60 për qind
33 03 00 90	Ujëra tualeti	60 për qind
33 07 20 00	Deodorante	60 për qind
VII	LLAMPA INKADESHENTE	
85 39 21 92	Më tepër se 100 V	200 për qind
85 39 21 98	Jo më tepër se 100 V	200 për qind
85 39 22 10	Llampat reflektor	200 për qind

85 39 22 90	Të tjera	200 për qind
85 39 29 92	Më tepër se 100 V	200 për qind
85 39 29 98	Jo më tepër se 100 V	200 për qind

LIGJ

Nr. 10 148, datë 28.9.2009

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9920, DATË 19.5.2008 “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, pas nenit 75 shtohet neni 75/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 75/1

Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore

Nëse personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH, rezultojnë me tepërcë kreditore dhe paraqesin, pranë drejtorisë rajonale tatimore, kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër, administrata tatimore, brenda 30 ditëve kalendarike, verifikon saktësinë e pretendimit, njofton tatimpaguesin dhe realizon rimbursimin, kur plotësohen kushtet. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mospagesës së detyrimeve të tjera tatimore, në masën e TVSH-së së pretenduar për rimbursim.

Mënyra dhe procedurat e hollësishme teknike për zbatimin e këtij neni përcaktohen në udhëzimin e Ministrit të Financave.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6283, datë 7.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 149, datë 28.9.2009

**PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË LIGJIN NR.10 033, DATË 11.12.2008 “PËR
LOJËRAT E FATIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 12, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Shoqëritë e miratuara dhe të licencuara në fushën e lojërave të fatit derdhen në llogarinë e Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit 0,5 për qind të xhiros vjetore, por jo më pak se:

a) 2 000 000 (dy milionë) lekë në vit për shoqëritë e licencuara për kazino dhe lotari kombëtare;

b) 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë në vit për shoqëritë që organizojnë kazino elektronike;

c) 1 000 000 (një milion) lekë në vit për shoqëritë që organizojnë baste sportive dhe baste për gara në pistë;

ç) 300 000 (treqind mijë) lekë në vit për shoqëritë që organizojnë bingo tradicionale e televizive.”.

Neni 2

Në nenin 44 bëhen ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 5.3, shkronjat “a”, “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

“a) për rrethet e kategorisë së parë, 400 000 (katërqind mijë) lekë për çdo sallë dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot e videolotari;

b) për rrethet e kategorisë së dytë, 200 000 (dyqind mijë) lekë për çdo sallë dhe 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot e videolotari;

c) për rrethet e kategorisë së tretë, 100 000 (njëqind mijë) lekë për çdo sallë dhe 40 000 (dyzet mijë) lekë për çdo makinë elektronike të tipit slot e videolotari;

ç) për çdo makinë elektronike me më shumë se një pozicion (ruletë) organizatori paguan një kuotë fikse mujore prej 1 000 000 (një milion) lekësh dhe 300 000 lekësh në muaj për çdo pozicion loje, pavarësisht nga rrethi ku ushtron veprimtarinë.”.

Neni 3

Në nenin 45 pika 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c” ndryshohen si më poshtë:

“a) për tryezat me më shumë se një pozicion (ruletë), një taksë mujore në masën 300 0000 (treqind mijë) lekë në muaj për çdo pozicion;

b) për çdo tryezë të lojërave (me letra ose/dhe me zare), një taksë mujore në masën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë;

c) për lojërat elektronike dhe makinat slot, me fitim në çast dhe për videolotarinë, të vendosura në mjediset e kazinosë, një taksë mujore në masën 120 000 (njëqind e njëzetë mijë) lekë, për çdo kompjuter elektronik”.

Neni 4

Në nenin 51, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) konfiskimin e mjeteve të lojërave, magazinimin, si dhe shkatërrimin e tyre;”

Neni 5

Në nenin 61 “Dispozita kalimtare”, në fund të pikës 2 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Organi tatimor kryen rimbursimin e shumave të dëmshpërblimit për subjektet, të cilave u është revokuar me ligj licenca për kategoritë e lojërave “lotari çasti” dhe “lotari me shorte”.

Kriteret, mënyra, masa dhe forma e dëmshpërblimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6284, datë 7.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 154, datë 28.9.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 025, DATË 27.11.2008 “PËR BUXHETIN E VITIT 2009”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Buxheti për vitin 2009 është:

Të ardhurat	326 117	milionë lekë;
Shpenzimet	400 908	milionë lekë;
Deficiti	74 791	milionë lekë.

Buxheti i Shtetit përbëhet nga fondi i konsoliduar, buxheti i sigurimeve shoqërore dhe buxheti i sigurimeve shëndetësore.”.

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

Buxheti i Shtetit, për vitin 2009, është:

Të ardhurat	253 804	milione lekë;
Shpenzimet	328 595	milione lekë;
Deficiti	74 791	milione lekë.”.

Neni 3

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Buxheti i sigurimeve shoqërore, për vitin 2009, është:

1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror:

- Të ardhurat, gjithsej	67 109	milione lekë.
Nga të cilat:		
- Kontributet	47 332	milione lekë;
- Transferimet nga Buxheti i Shtetit	19 777	milione lekë.
- Shpenzimet	67 109	milione lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet nga Këshilli i Ministrave dhe ndryshon sa herë që rriten pagat dhe pensionet. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përcaktojë një kontribut të veçantë minimal për personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe për kategori të veçanta të personave të vetëpunësuar. Diferenca ndërmjet kontributeve të veçanta me kontributin minimal mbulohet nga subvencionet e Buxhetit të Shtetit, por brenda kufirit të transfertave, të përcaktuara në këtë ligj. Për vitin 2009, teprica e të ardhurave, sipas degëve të sigurimit shoqëror, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

2. Skema e sigurimit suplementar

- Të ardhurat, gjithsej	4 546	milione lekë;
Nga të cilat:		
- Kontributet	190	milione lekë;
- Transferimet nga Buxheti i Shtetit	4 356	milione lekë.
Shpenzimet	4 546	milione lekë.”.

Neni 4

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Të ardhurat e fondit të konsoliduar, sipas grupeve kryesore, janë:

- Grantet	6 313	milione lekë;
- Të ardhurat tatimore	295 982	milione lekë;
- Të ardhurat jotatimore	24 822	milione lekë;
- Të ardhurat e buxhetit vendor	18 412	milione lekë.”.

Neni 5

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Kufiri i financimit të deficitit të Buxhetit të Shtetit është 74 791 milionë lekë, prej të cilit 27 794 milionë lekë financohen nga të ardhurat nga privatizimi. Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja për financimin e deficitit, të brendshëm dhe të huaj, prej 53 667 milionë lekësh, nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve.

Të ardhurat e arkëtuara nga privatizimi strategjik i OSSH sha-së përdoren në masën 50 për qind për reduktimin e borxhit të përgjithshëm publik. Pjesa tjetër e të ardhurave nga ky privatizim përdoret nga Këshilli i Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve për investime, jo më shumë se 30 për qind, për kompensimin e ish të përndjekurve politikë, në masën 10 për qind dhe për kompensimin e ish-pronarëve, 10 për qind, fond i cili, automatikisht, rrit kufirin e deficitit të Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar në nenet 1 e 2 të këtij ligji. Të ardhurat e arkëtuara nga privatizimi strategjik i ARMO sha-së, të papërdorura gjatë vitit 2008, 9 790 milionë lekë, përdoren në masën 50 për qind, për reduktimin e huamarrjes së brendshme dhe 50 për qind, nga Këshilli i Ministrave, për rritjen e kufirit të shpenzimeve për investime, i cili, automatikisht, rrit kufirin e deficitit të Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar në nenet 1 e 2 të këtij ligji.”.

Neni 6

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Shpenzimet e Buxhetit të Shtetit, sipas grupeve kryesore, janë:

- Shpenzimet korrente	213 155	milionë lekë;
- Shpenzimet kapitale	100 519	milionë lekë;
- Fondi rezervë	2 600	milionë lekë;
- Fondi i kontingjencës për politika pagash dhe pensionesh	7 700	milionë lekë;
- Fondi i kontingjencës	4 621	milionë lekë.

Kufiri i shpenzimeve për çdo ministri dhe institucion, në nivel programi, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për institucionet e pavaruara nga Këshilli i Ministrave, kufiri i shpenzimeve dhe numri i punonjësve janë sipas tabelës 1/1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet operative, të cilat janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha institucionet buxhetore, në varësi ose jo të Këshillit të Ministrave, si edhe nga organet e pushtetit vendor.”.

Neni 7

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Fondi rezervë, prej 2 600 milionë lekësh, përdoret për rastet e paparashikuara të institucioneve buxhetore. Fondi i kontingjencës për ruajtjen e deficitit është 4 621 milionë lekë, nga i cili një fond deri në 100 milionë lekë mund të përdoret si “Mbështetje për shoqërinë civile”, sipas përcaktimeve të bëra në një ligj të veçantë për financimin e organizatave jofitimprurëse. Fondi i

kontingjencës për ruajtjen e deficitit dhe ai për rritjen e pagave e të pensioneve përdoren nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 8

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Buxheti i Kuvendit të Shqipërisë është 1 031 milionë lekë. Përcaktimi me hollësi i fondeve buxhetore bëhet nga vetë Kuvendi, në zbatim të ligjit për statusin e deputetit dhe të rregullores së këtij institucioni.”.

Neni 9

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

1. Shtesa e stokut të borxhit deri në fund të vitit 2009 parashikohet të arrijë në 77 914 milionë lekë (përfshirë ndikimin e kursit të këmbimit prej 15 500 milionë lekësh), sipas përshkrimit me hollësi, si më poshtë:

a) Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit, për financimin e deficitit të buxhetit të vitit 2009, është 73 161 milionë lekë, nga i cili:

i) për financimin e projekteve të drejtpërdrejta të Këshillit të Ministrave, 32 737 milionë lekë;

ii) për mbështetjen buxhetore, 40 424 milionë lekë.

b) Kufiri për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, është 7 519 milionë lekë, përfshirë edhe fondin prej 200 milionë lekësh për garantimin e kredive të eksportit, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që ushtrojnë veprimtari në prodhimin për eksport.

c) Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra, të jashtme, të papaguara, është 1 904 milionë lekë.

ç) Ulja e stokut të borxhit, si rezultat i rivlerësimit të valutës së Bankës së Shqipërisë, është 4 670 milionë lekë.

2. Kufiri i stokut të borxhit shtetëror (pa garancitë), për vitin 2009, është 629 635 milionë lekë.

3. Kufiri i garancive shtetërore, për vitin 2009, është 44 060 milionë lekë.”.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6289, datë 7.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Tab.1

BUXHETI I VITIT 2009 (i Rishikuar) SIPAS MINISTRIVE TE LINJES DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

ne 000/leke

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shp. Kapitale	Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Nga Buxheti	Nga te Ardhurat	Financimi i Huaj		
1	Presidenca	162,000	42,000	0	0	42,000	204,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	162,000	42,000	0	0	42,000	204,000
2	Kuvendi	894,000	137,000	0	0	137,000	1,031,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	894,000	137,000	0	0	137,000	1,031,000
3	Keshilli Ministrave	357,000	12,000	0	0	12,000	369,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	357,000	12,000	0	0	12,000	369,000
4	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	1,123,000	405,075	0	948,543	1,353,618	2,476,618
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	335,000	26,000	0	0	26,000	361,000
04320	Mbeshtetje per Energjine	1,000	52,000	0	216,000	268,000	269,000
04430	Mbeshtetje per Burimet Natyrore	145,500	57,000	0	0	57,000	202,500
04440	Mbesht. Miniera e Nd/je Publike	62,000	63,000	0	150,000	213,000	275,000
04130	Mbeshtetje per Zhvillim Ekonomik	225,500	180,075	0	352,543	532,618	758,118
04160	Mbeshtetje per Mbikq. e Tregut, Infrast. e Ciles. dhe Pron. Industr.	347,000	27,000	0	80,000	107,000	454,000
04770	Mbeshtetje per Zhvillim Rajonal	7,000	0	0	150,000	150,000	157,000
5	Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit	4,129,912	1,258,947	0	619,861	1,878,808	6,008,720
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	227,159	20,000	0	0	20,000	247,159
04220	Siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorit	1,373,644	57,198	0	71,900	129,098	1,502,742
04240	Menaxhimi i infrastruktures se kullimit dhe ujitjes	730,130	918,005	0	354,700	1,272,705	2,002,835
04250	Zhvillimi Rural duke mbesht. Prodh. Bujq. Blek, Agroind dhe Market.	1,577,334	196,366	0	193,261	389,627	1,966,961
04860	Keshillimi dhe Informacioni Bujqesor	208,045	67,378	0	0	67,378	275,423
05470	Menaxhimi gendrueshem i tokes bujqesore	13,600	0	0	0	0	13,600
6	Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	4,880,600	62,523,320	0	10,410,449	72,933,769	77,814,369
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	303,000	6,000	0	0	6,000	309,000
04520	Rrjeti i rrugeve nacionale	1,670,100	58,629,080	0	8,056,096	66,685,176	68,355,276
04530	Menaxhimi i Transportit	24,000	0	0	0	0	24,000
04540	Portet	65,000	166,000	0	380,000	546,000	611,000
04550	Hekurudhat	502,000	72,730	0	0	72,730	574,730
04560	Aviacioni Civil	73,500	26,500	0	0	26,500	100,000
06370	Ujesjelles Kanalizime	948,000	3,204,678	0	1,524,353	4,729,031	5,677,031
06180	Strehimi dhe Urbanistika	1,141,000	280,332	0	450,000	730,332	1,871,332
06220	Sherbimet publike	154,000	138,000	0	0	138,000	292,000
10	Ministria e Financave	5,893,600	495,358	0	470,700	966,058	6,859,658
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	178,000	64,662	0	184,500	249,162	427,162
01120	Menaxhimi i Shpenzimeve Publike	379,700	4,000	0	0	4,000	383,700
01130	Ekzekutimi i Pagesave te Ndryshme	184,000	0	0	0	0	184,000
01140	Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	2,013,000	121,696	0	0	121,696	2,134,696
01150	Menaxhimi i te Ardhurave Doganore	1,370,000	303,000	0	286,200	589,200	1,959,200
01160	Lufta kunder Transaksioneve Financiare Jo-Ligjore	66,900	2,000	0	0	2,000	68,900
10270	Menaxhimi i Sigurimeve Shogerore	1,644,000	0	0	0	0	1,644,000
01180	Auditimi i Brendshem dhe Kontrolli i Financave Publike	58,000	0	0	0	0	58,000
11	Ministria e Arsimit dhe Shkences	32,575,500	4,335,325	1,045,000	1,265,013	6,645,338	39,220,838
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	904,900	65,331	0	20,000	85,331	990,231
09120	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	18,265,600	2,725,892	0	700,205	3,426,097	21,691,697
09230	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	3,750,000	693,732	0	279,808	973,540	4,723,540
09240	Arsimi i Mesem (profesional)	2,033,000	359,370	0	40,000	399,370	2,432,370
09450	Arsimi Universitar	7,462,000	491,000	1,045,000	225,000	1,761,000	9,223,000
09770	Fonde per Shkencen	160,000	0	0	0	0	160,000
12	Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	1,500,400	548,560	0	0	548,560	2,048,960
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	139,500	1,800	0	0	1,800	141,300
08220	Trashegimia Kulturore, Muzete dhe Kultet	379,400	169,600	0	0	169,600	549,000
08230	Arti dhe Kultura	651,000	322,832	0	0	322,832	973,832
08140	Zhvillimi i Sportit	218,000	52,000	0	0	52,000	270,000
08170	Programe per Rinine	15,000	0	0	0	0	15,000
04760	Zhvillimi i Turizmit	97,500	2,328	0	0	2,328	99,828
13	Ministria e Shendetesise	21,289,800	2,545,059	37,000	1,020,000	3,602,059	24,891,859
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	226,000	41,090	0	0	41,090	267,090
07220	Sherbimet e Kujdesit Paresor	6,005,000	453,417	10,000	250,000	713,417	6,718,417
07330	Sherbimet e Kujdesit Dytesor	12,875,200	1,985,634	20,000	770,000	2,775,634	15,650,834
07450	Sherbimet e Shendetit Publik	2,183,600	64,918	7,000	0	71,918	2,255,518

Tab.1

BUXHETI I VITIT 2009 (i Rishikuar) SIPAS MINISTRIVE TE LINJES DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

		ne 000/leke					
14	Ministria e Drejtësisë	6,028,154	300,990	0	842,400	1,143,390	7,171,544
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	235,167	53,970	0	232,400	286,370	521,537
01120	Publikimet Zyrtare	49,872	500	0	0	500	50,372
01130	Mjekësia Ligjore	46,233	10,000	0	0	10,000	56,233
03440	Sistemi i Burgjeve	3,115,500	212,780	0	560,000	772,780	3,888,280
03350	Sherbimi i Permbarimit Gjyqësor	160,620	5,000	0	0	5,000	165,620
01160	Sherbimet per çështjet e biresimeve	14,009	500	0	0	500	14,509
01170	Sherbimi i Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme	459,000	18,240	0	50,000	68,240	527,240
01180	Sherbimi i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	1,947,753	0	0	0	0	1,947,753
15	Ministria e Puneve te Jashtme	1,758,100	90,718	0	0	90,718	1,848,818
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	52,100	4,955	0	0	4,955	57,055
01120	Perfaqesite Diplomatike	1,457,000	83,890	0	0	83,890	1,540,890
01130	Promovimi i imazhit te vlerave te vendit	122,000	158	0	0	158	122,158
01140	Integrimi europian dhe euro-atlantik	127,000	1,715	0	0	1,715	128,715
16	Ministria e Brendshme	13,476,300	913,814	58,000	916,373	1,888,187	15,364,487
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	617,137	40,000	16,000	0	56,000	673,137
01330	Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike	70,000	15,000	0	0	15,000	85,000
03140	Policia e Shtetit	9,910,163	624,046	42,000	916,373	1,582,419	11,492,582
03150	Garda e Republikes	1,218,000	40,000	0	0	40,000	1,258,000
01160	Prefekturat dhe Funkcionet e Deleguara te P. Vendor	534,200	14,700	0	0	14,700	548,900
01170	Sherbimi i Gjendjes Civile	426,000	165,068	0	0	165,068	591,068
01180	Menaxhimi i Rezervave te Shtetit	96,800	5,000	0	0	5,000	101,800
10910	Emergjencat Civile	604,000	10,000	0	0	10,000	614,000
17	Ministria e Mbrojtjes	16,583,000	4,212,864	100,000	600,000	4,912,864	21,495,864
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,085,000	39,000	0	0	39,000	1,124,000
02120	Forcat e Luftimit	5,908,000	2,930,390	0	0	2,930,390	8,838,390
09430	Arsimi Ushtarak	1,284,000	326,973	0	0	326,973	1,610,973
07340	Mbeshtetje Shendetesore	539,000	61,000	0	600,000	661,000	1,200,000
02150	Mbeshtetja e Luftimit	3,831,000	582,377	100,000	0	682,377	4,513,377
02160	Mbeshtetja e Pergendruar	436,000	223,000	0	0	223,000	659,000
10270	Mbeshtetje Sociale per Ushtaraket	2,886,000	0	0	0	0	2,886,000
02280	Bashkepunimi Civilo - Ushtarak (AL-CIMIC)	614,000	50,124	0	0	50,124	664,124
18	Sherbimi Informativ Shtetror	1,087,100	90,420	0	0	90,420	1,177,520
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,087,100	90,420	0	0	90,420	1,177,520
19	Drejtoria e Radio Televizionit	439,000	100,000	0	0	100,000	539,000
08310	Sherbimet per shqiptaret jashte kufirit dhe sherbimi per te huajt ne gjuhe huaj + Sateliti	349,000	0	0	0	0	349,000
08520	Projekte teknike per futjen e teknologjive te reja	0	100,000	0	0	100,000	100,000
	Prodhime filmike ose veprimtari artistike						
08330	mbarekombetare	50,000	0	0	0	0	50,000
08340	Orkestra Simfonike e RTSH dhe Kinematografise	40,000	0	0	0	0	40,000
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	149,000	21,000	0	0	21,000	170,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	149,000	21,000	0	0	21,000	170,000
22	Akademia e Shkences	82,800	2,000	0	0	2,000	84,800
01510	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	82,800	2,000	0	0	2,000	84,800
24	Kontrolli Larte i Shtetit	276,000	9,000	0	0	9,000	285,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	276,000	9,000	0	0	9,000	285,000
25	Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta	39,198,200	55,500	5,000	88,000	148,500	39,346,700
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	130,400	3,000	0	0	3,000	133,400
10220	Sigurimi Shogoror	19,609,250	2,000	0	88,000	90,000	19,699,250
10430	Mbrojtja Sociale	17,731,800	0	0	0	0	17,731,800
10550	Tregu i Punes	1,565,800	50,500	5,000	0	55,500	1,621,300
04170	Inspektimi ne Pune	149,500	0	0	0	0	149,500
10460	Shanset e Barabarta	11,450	0	0	0	0	11,450
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	1,138,900	256,600	50,000	514,000	820,600	1,959,500
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	72,000	3,600	0	0	3,600	75,600
05320	Programe per mbrojtjen e Mjedisit	104,000	0	0	204,000	204,000	308,000
04230	Mbeshtetje per Peshkimin	62,000	110,000	0	120,000	230,000	292,000
05640	Administrimi i Ujrave	29,000	0	0	0	0	29,000
04260	Administrimi i Pyjeve	871,900	143,000	50,000	190,000	383,000	1,254,900
28	Prokuroria e Pergjithshme	1,138,000	48,000	0	0	48,000	1,186,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,138,000	48,000	0	0	48,000	1,186,000

Tab.1

BUXHETI I VITIT 2009 (i Rishikuar) SIPAS MINISTRIVE TE LINJES DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE

ne 000/leke

29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqesor	1,474,000	164,350	0	0	164,350	1,638,350
03310	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	1,474,000	164,350	0	0	164,350	1,638,350
30	Gjykata Kushtetuese	94,760	4,000	0	0	4,000	98,760
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	94,760	4,000	0	0	4,000	98,760
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	91,000	2,000	0	3,000	5,000	96,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	91,000	2,000	0	3,000	5,000	96,000
40	Partite Politike	200,000	0	0	0	0	200,000
01110	Mbeshetje per Partite Politike	192,000	0	0	0	0	192,000
01120	Mbeshetje per Shoqatat	5,000	0	0	0	0	5,000
01130	Mbeshetje per Organizatat e Veteraneve me Status	3,000	0	0	0	0	3,000
50	Instituti Statistikes	203,700	5,000	0	5,000	10,000	213,700
01310	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	203,700	5,000	0	5,000	10,000	213,700
53	Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare	0	0	0	0	0	0
04110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0	0	0	0	0	0
55	Shkolla e Magjistratures	55,900	1,000	0	0	1,000	56,900
03310	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	55,900	1,000	0	0	1,000	56,900
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	700,000	0	1,772,900	2,472,900	2,472,900
06210	Programe Zhvillimi	0	700,000	0	1,772,900	2,472,900	2,472,900
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	131,100	2,000	0	0	2,000	133,100
08210	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	131,100	2,000	0	0	2,000	133,100
59	Instituti i Integrimit te Perndjekurve Politik	26,200	2,000	0	0	2,000	28,200
01110	Rehabilitimi i te Perndjekurve Politik	26,200	2,000	0	0	2,000	28,200
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	77,100	2,000	0	0	2,000	79,100
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	77,100	2,000	0	0	2,000	79,100
66	Avokati i Popullit	85,700	5,000	0	0	5,000	90,700
03310	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	85,700	5,000	0	0	5,000	90,700
67	Komisioni i Sherbimit Civil	46,300	1,000	0	0	1,000	47,300
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	46,300	1,000	0	0	1,000	47,300
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	693,800	2,000	0	0	2,000	695,800
01610	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	93,800	2,000	0	0	2,000	95,800
01620	Zgjedhjet e pergjithshme dhe lokale	600,000	0	0	0	0	600,000
76	Inspektoriati i Larte i Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	90,600	2,000	0	0	2,000	92,600
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	90,600	2,000	0	0	2,000	92,600
77	Autoriteti i Konkurences	58,500	3,000	0	0	3,000	61,500
04110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	58,500	3,000	0	0	3,000	61,500
78	Ministria e Integrimit	154,750	5,250	0	0	5,250	160,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	41,750	3,650	0	0	3,650	45,400
01140	Drejtesia dhe Tregu i Brendshem	27,000	800	0	0	800	27,800
01150	Mbeshetja Institucionale per Procesin e Integrimit	86,000	800	0	0	800	86,800
82	Keshilli Kombetar i Kontabilitetit	14,100	2,000	0	0	2,000	16,100
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	14,100	2,000	0	0	2,000	16,100
86	Avokati i Prokurimeve	26,000	2,000	0	0	2,000	28,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	26,000	2,000	0	0	2,000	28,000
87	Institucione te tjera Qeveritare	262,000	354,183	0	80,000	434,183	696,183
01320	Sherbime Qeveritare	80,000	79,483	0	0	79,483	159,483
01130	Sherbime i Prokurimit Publik	67,000	69,700	0	0	69,700	136,700
01140	Sherbime per shoqerite e informacionit	45,000	197,000	0	80,000	277,000	322,000
01150	Sherbime te tjera	70,000	8,000	0	0	8,000	78,000
88	Mbeshetje per Shoqerine Civile	0	0	0	0	0	0
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0	0	0	0	0	0
89	Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale	46,000	5,000	0	0	5,000	51,000
01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	46,000	5,000	0	0	5,000	51,000
TOTALI		157,991,876	79,667,333	1,295,000	19,556,239	100,518,572	258,510,448

Tab.1.1

Ne 000/leke

Kodmin	Institucionet e pavarura	Nr. punonjesve	Buxheti Total
1	Presidenca	80	204,000
2	Kuvendi	477	1,031,000
24	Kontrolli i Larte i Shtetit	160	285,000
28	Prokuroria e Pergjithshme	807	1,186,000
29	Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	1,230	1,638,350
30	Gjykata Kushtetuese	50	98,760
55	Shkolla e Magjistratures	22	56,900
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	41	79,100
66	Avokati i Popullit	50	90,700
67	Komisioni i Sherbimit Civil	28	47,300
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	60	695,800
76	Inspektoriati i Larte i Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	45	92,600
77	Autoriteti i Konkurences	35	61,500
86	Avokati i Prokurimeve	15	28,000
89	Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale	30	51,000

Tab.2

Buxheti i vitit 2009 (i Rishikuar) per Pushtetin Gjyqesor
ne 000/leke

Nr	Emertimi	Korente	Investime	Totali
1	Gjykata e Larte	195,500	4,565	200,065
2	Gjykatat e Apelit	260,000	8,850	268,850
3	Gjykatat e Faktit	973,800	149,485	1,123,285
4	Z.A.B.GJ.	44,700	1,450	46,150
	Shuma	1,474,000	164,350	1,638,350

Tab.4

ne 000/leke

	Funkcioni	600	601	602	603	604	605	606	230	231	Totali
	Sherbimet e Pergjithshme Publike	9,207,011	1,492,279	6,031,150	80,000	857,100	413,500	2,018,000	61,410	2,680,418	22,840,868
01	Mbrojtja Rendi dhe Siguria Publike	4,843,000	723,000	4,598,000	0	0	0	625,000	10,000	3,875,891	14,674,891
02	Ceshjtjet Ekonomike	10,447,762	1,608,621	3,372,500	0	0	0	591,000	49,704	2,520,845	18,590,432
03	Ceshjtjet Fetare	2,728,739	520,900	2,948,014	484,000	119,000	30,500	1,420,000	833,273	70,301,887	79,386,313
04	Mbrojtja e Mjedisit	68,000	11,000	49,600	0	18,000	0	0	0	204,000	350,600
05	Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit	347,000	63,000	829,000	878,000	0	0	126,000	142,780	7,927,483	10,313,263
06	Shendetesia Argetimi, Kultura dhe Ceshjtjet Fetare	1,982,660	413,600	1,282,540	0	24,211,000	70,000	22,000	46,990	4,174,979	32,203,769
07	Arsimi	636,000	105,000	193,000	0	893,200	6,300	0	0	646,432	2,479,932
08	Mbrojtja Sociale	20,104,000	2,974,000	2,281,600	380,000	6,349,000	0	866,000	82,598	6,804,382	39,841,580
09	Shpenzime te tjera te paklasifikuara*	1,095,400	175,200	385,700	200,000	71,723,000	4,000	17,991,000	2,000	153,500	91,729,800
	Totali	51,459,572	8,086,600	21,971,104	2,022,000	104,170,300	524,300	23,659,000	1,228,755	99,289,817	400,907,448
											88,496,000

* Ne zerin "Shpenzime te tjera te paklasifikuara" (Totali) jane perfshire: (i) pagesat per sherbimin e borxhit, (ii) kontigjencia per politika pagash dhe pensionesh, (iii) fondi rezerve, dhe (iv) shpenzimet e pushtetit vendor.

** Shpenzimet e pushtetit vendor nuk jane shperndare sipas funksioneve pasi ndarja e tyre eshte kompetence e ketij pushteti

Tab.5

Te tjera shpenzime te paperfshira ne buxhetet e Ministrive dhe Institucioneve	Totali
Fondi Rezerve dhe Kontigjence i Keshillit te Ministrave	14,921,000
Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	2,600,000
Fondi Rezerve per Politike Pagash (e pakushtezuar)	0
Fondi Kontigjence per Politika Pagash dhe Pensionesh	7,700,000
Fondi Kontigjence per Ruajtjen e Deficitit	4,621,000
Interesat	36,740,000
Per borxhin e brendshem	31,420,000
Per borxhin e huaj	5,320,000
Shpenzimet e Pushtetit Vendor	36,835,000
Nga te ardhurat e veta	18,412,000
Granti per pushteti vendor	18,423,000
Te ardhura jashte limitit	0
Te ardhurat e ISSH dhe ISKSH	53,901,000
Net Lending	0
Totali	142,397,000

Tab.6

TREGUESIT FISKALE TE BUXHETIT TE KONSOLIDUAR 2009 (I RISHIKUAR)
(FISCAL INDICATORS REGARDING CONSOLIDATED BUDGET OF 2009 [REVISED])

ne milion leke (in million of leks)

Nr.	E M E R T I M I	Buxheti 2009 (i Rishikuar)	Ne % te PBB	Buxheti i Shtetit	Buxheti i Fondeve Speciale	Buxheti Vendor	I T E M S
I.	TOTALI TE ARDHURAVE	326,117	27.72%	253,804	53,901	18,412	TOTAL REVENUE
	Te ardhura nga ndihmat	6,313	0.54%	6,313			Grants
	Nga kjo: Mbeshtetje buxhetore						From which: Budget Support
II.	Te ardhura tatimore	295,982	25.16%	222,669			Tax Revenue
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	222,669	18.93%	222,669			From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vleren e Shtuar	114,657	9.75%	114,657			V.A.T
2	Tatimi mbi Fitimin	17,559	1.49%	17,559			Profit Tax
3	Akcizat	36,795	3.13%	36,795			Excise Tax
4	Tatimi mbi te Ardhurat Personale	30,611	2.60%	30,611			Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe te tjera	15,210	1.29%	15,210			National Taxes and others
6	Taksa Doganore	7,837	0.67%	7,837			Customs Duties
II.2	Te ardhura nga Pushteti Vendor	18,412	1.57%			18,412	Local Taxes
1	Taksa Lokale	11,114	0.94%			11,114	Local Taxes
2	Tatimi mbi Pasurine (ndertesat)	3,734	0.32%			3,734	Property Tax
3	Tatimi mbi Biznesin e vogel	3,564	0.30%			3,564	Small Business Tax
II.3	Te ardh Buxh. Pavarur (kontribute)	53,901	4.58%		53,901		Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqeror	47,522	4.04%		47,522		Social Insurance
2	Sigurimi Shendetesor	6,379	0.54%		6,379		Health insurance
III.	Te ardhura Jotatimore	24,822	2.11%	24,822			Nontax Revenue
1	Tran. Fitimi nga Banka e Shqiperise	5,700	0.48%	5,700			Profit transfer from BOA
2	Te ardhura nga Institucionet Buxhetore	11,857	1.01%	11,857			Income of budgetary institutions
3	Dividenti	165	0.01%	165			Divident
4	Tarifat e Sherbimeve	3,800	0.32%	3,800			Other/not allocated
5	Te tjera	3,300	0.28%	3,300			
I.	TOTALI I SHPENZIMEVE	400,908	34.08%	268,207	95,866	36,835	TOTAL EXPENDITURE
1	Shpenzime Korrente	285,468	24.27%	152,767	95,866	36,835	Current Expenditures
	Personeli	59,546	5.06%	59,546			Personnel expenditures
	Paga	51,460	4.37%	51,460			Wages
	Kontributi per Sigurime Shoqerore	8,087	0.69%	8,087			Social insurance contributions
	Politikat e reja pagash						Of which: Contingency for new policies
2	Interesat	36,740	3.12%	36,740			Interest
	Te Brendshme	31,420	2.67%	31,420			Domestic
	Te Huaja	5,320	0.45%	5,320			Foreign
3	Shpenzime Operative Mirembajtje	34,698	2.95%	34,698			Operational & Maintenance
	Nga e cila: Financim i Huaj						From which: Foreign Financing
	Shpenzime per planifikim, menaxhim & administrim						Contingency
4	Subvencionet	2,022	0.17%	2,022			Subsidies
5	Shpenzime per Sig. Shoq e Shendet	95,866	8.15%		95,866		Social insurance outlays
	Sigurime Shoqerore	71,655	6.09%		71,655		Social insurance
	Sigurime Shendetesore	24,211	2.06%		24,211		Health insurance
6	Shpenzime per Buxhetin Vendor	36,835	3.13%			36,835	Local Budget expenditure
	Buxheti Vendor (Granti)	18,423	1.57%			18,423	Local Budget (Grant)
	Buxheti Vendor (Te ardhurat e veta)	18,412	1.57%			18,412	Local Budget (Own revenues)
7	Shpenzime te tjera	17,991	1.53%	17,991			Other expenditures
	Pagesa e Papunesise	950	0.08%	950			Unemployment insurance benefits
	Ndihma Ekonomike	13,871	1.18%	13,871			Social assistance
	Kompensim per ish te perndjekurit politike	3,170	0.27%	3,170			Compensation for ex political prisoners
	Kompensim per energjine elektrike						Compensation for electricity
8	Kompensim ne vlere i pronareve	1,770	0.15%	1,770			Property Compensation
II.	Fondi Rezerve, Kontigjenca	14,921	1.27%	14,921			Reserve fund, Contingency
	Fondi Rezerve i Keshillit te Ministrave	2,600	0.22%	2,600			CoM Reserve Fund
	Fondi Kontigjenca per Politika Pagash dhe Pensionesh	7,700	0.65%	7,700			Contingency for Wages and Pensions
	Fond Kontigjenca	4,621	0.39%	4,621			Increase
III.	Shpenzime Kapitale	100,519	8.54%	100,519			Capital expenditures
	Financimi Brendshem	80,962	6.88%	80,962			Domestic financing
	Nga e cila: Kontigjenca						Of which: Contingency
	Per Investime Publike	5,000	0.43%	5,000			for Public Investment
	Per rrugen Rreshen-Kalimash	40,031	3.40%	40,031			
	Financimi Huaj per projekte	19,556	1.66%	19,556			Foreign financing
IV	Net lending	0		0			
	DEFICITI	-74,791	-6.36%	-14,403	-41,965	-18,423	Cash Balance
	FINANCIMI DEFICITIT	74,791	6.36%	14,403	41,965	18,423	Financing (Cash)
	Brendshem	68,218	5.80%				Domestic
	Te ardhura nga privatizimi	27,794	2.36%				Privatization receipts
	Hua-marreje e brendshme	40,424	3.44%				Domestic borrowing
	I Huaj	6,573	0.56%				Foreign
	Hua afatgjate (e marre) per projekte	13,243	1.13%				Long-term Loan(Drawings)
	Ripagesat	-6,670	-0.57%				Repayments
	Produkti i Brendshem Bruto (PBB) 2009	1,176,349					

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 9.10.2009
Doli nga shtypi më 12.10.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 28 lekë